



### Konferenca e 3-të Ndërkombëtare Studentore në Universitetin e Elbasanit

Në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", u mbajt me sukses Konferenca e 3-të Ndërkombëtare Studentore "Inovacioni i udhëhequr nga studentët: Fuqizimi i gjeneratës së ardhshme". Kjo konferencë solli si risi këtë vit Simpoziumin e Karrierës dhe Aftësive, duke u dhënë mundësinë studentëve për zhvillimin dhe orientimin e karrierës, si dhe të krijojë kontakte të drejtpërdrejta me punëdhënësit potencialë e të nxisë punësimin e tyre me informacion nga ekspertë të fushës. Në fjalën e tyre përshëndetëse dy zëvendësrektorët e Universitetit të Elbasanit, Prof. Peçi Naqellari dhe Prof. Elvira Fetahu, shprehën vlerësim për pjesëmarrjen e gjerë të studentëve, si nga vendi por edhe nga bota, për angazhimin dhe cilësinë e punimeve të tyre kërkimore shkencore në të gjitha fushat që mbulon Universiteti i Elbasanit. Gjithashtu shprehën një falënderim të veçantë për personelin akademik dhe administrativ për mbështetjen e pakushtëzuar në çdo aktivitet që ka në qendër studentin. Në përfundim të aktivitetit për studentët u shpërndanë certifikatat e pjesëmarrjes, si edhe çmime të ndryshme. Punimet e tyre do të botohen në Librin e Abstrakteve të Konferencës dhe në Buletinin Special të Universitetit të Elbasanit.

### Qendra EIT RawMaterials



Hapet ne ambientet e Universitetit te Elbasanit, "Qendra Rajonale e Inovacionit e Institutit Evropian të Teknologjisë dhe Inovacionit për Lëndët e Para 'EIT RawMaterials'. Kjo qendër ka ne fokus nxitjen e kërkimit shkencor në këtë fushë, shkëmbimin e eksperiencës dhe rritjen e bashkëpunimit mes profesionistëve shqiptar dhe atyre të Bashkimit Evropian.

### Simpoziumi i Karrierës dhe Aftësive



Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", organizoi me sukses për studentët e tij Simpoziumin e Karrierës dhe Aftësive dhe Konferencën e 3-të Ndërkombëtare Studentore, një iniciativë unike në llojin e saj në këtë institucion. Ky aktivitet u çel me një panel të ftuarish të veçantë të cilët prezantuan për studentët mundësi konkrete për zhvillimin e tyre akademik dhe profesional, duke mos ngurruar të japin mesazhe inkurajuese dhe mbështetëse për rrugëtimin e tyre drejt suksesit.



# DITARI MUJOR

Prill 2024

## Konferenca Ndërkombëtare "Paqja, bota virtuale dhe lufta e armatosur" në Bari, Itali

Rektori i Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", Prof.dr. Skender Topi, së bashku me kolegë të universitetit, morën pjesë në Konferencën Ndërkombëtare "Paqja, bota virtuale dhe lufta e armatosur", organizuar në Universitetin e Barit "Aldo Moro", Itali. Në fjalën e tij, ai vuri theksin në rëndësinë që kanë tematika të tilla për t'u diskutuar në nivel akademik, duke parë momentet në të cilat rajoni, Europa dhe bota po kalojnë. Kjo konferencë u përshëndet gjithashtu nga Zëvendësministri i Drejtësisë të Italisë, Z. Francesco Paolo Sisto dhe Rektoria e Universitetit "Alcide De Gasperi" e Ekonomisë Eurorajonale, Znj. Magdalena Sitek. Në fund të fjalës së tij, Prof. Topi, ftoi organizatorët që konferenca e radhës të mbahej në Universitetin e Elbasanit.



## Trajnim me doktorantët në Universitetin e Elbasanit



Në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", u zhvillua me sukses trajnimi me në fokus doktorantët e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike. Trajnimi me temë "Përdorimi i platformës Qualtrics; një mjet për hartimin e pyetësorëve" u zhvillua nga Dr. Merita Hoxha dhe kishte në fokus njohjen me rrjetin kërkimor ndërdisiplinor COST Association, si ai ndihmon kërkuesit shkencorë, hartimi i pyetësorëve përmes platformës Qualtrics, si edhe trajtoi aspekte teorike duke vënë theksin në këshilla dhe rekomandime të vlefshme për të pranishmit. Trajnimi i zhvillua në bashkëpunim me COST Action 21114- CLIL Network for Languages in Education: Towards bi-and multilingual disciplinary literacies (CLILNetLE) dhe Dr. Craig Neville nga Koleji Universitar Cork.

## Panairi Mbarëkombëtar i Librit Akademik dhe Shkencor

Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", mori pjesë në panairin më të rëndësishëm të librit akademik dhe shkencor në Shqipëri, që këtë vit vjen si bashkëpunim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Akademisë së Shkencave e Arteve të Kosovës dhe Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit në Tiranë. Pranë stendës së Universitetit të Elbasanit, të pranishëm të ndryshëm, mundën të shihnin nga afër botimet më të reja akademike dhe shkencore, duke mos humbur gjithashtu edhe promovimin e titujve më të rinj në fushën e shkencave humane dhe të natyrës, në ambientet e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.





# DITARI MUJOR

Prill 2024

## Ditët e informimit dhe Edicioni i 16-të i Panairit "Work & Study" 2024



Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", zhvilloi me sukses ditët e informimit të maturantëve në qytete të ndryshme, si edhe mori pjesë në Edicionin e 16-të të Panairit "Work & Study" 2024, përfaqësuar nga Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, si edhe personeli akademik. Këto takime vijnë si qëllim për të informuar të rinjtë për gamën e gjerë të programeve të studimit që Universiteti i Elbasanit ofron, ku spikasim programet prioritare, për personelin e kualifikuar akademik, kushtet bashkëkohore infrastrukturore, ofrimin e këshillimit për studentët aktualë dhe ata të ardhshëm, programin Erasmus, si edhe mundësitë e kryerjes së praktikave profesionale nga studentët në sajë të marrëveshjeve të bashkëpunimit që UE ka me institucione publike dhe jopublike.

## Trajnim për përdorimin e inteligjencës artificiale



Në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", u zhvillua me sukses trajnimi me në fokus personelin akademik dhe studentët e ciklit doktorat në kuadrin e zhvillimit profesional. Trajnimi me temë "Përdorimi i AI Inteligjencës Artificiale në ndihmë të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor", u zhvillua nga Dr. Ymer Leksi dhe vjen si bashkëpunim i Departamentit të Gjuhësisë, Departamentit të Gjuhëve të Huaja dhe Rektoratit të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani".

## Klubi Studentor Vullnetari në Universitetin e Elbasanit



Studentët e Klubit Studentor Vullnetari, zgjedhën që në kuadër të muajit të Autizmit t'i bashkoheshin aktivitetit sportiv të organizuar nga Qendra e Autizmit, Elbasan. Për studentët kjo ishte një përvojë për të kontribuar në nxitjen e aftësive dhe talenteve të fëmijëve me autizëm në komunitetin tonë.